



BALLINA

LAJME ▾

VIDEO

BOTA

SPORT ▾

OPINION ▾

SHOWBIZ ▾

LIFESTYLE ▾

AUTO & TEK ▾

FUN ▾

ENGLISH ▾

## Policia për vrasjen në Klinë: Kreu krimin, i grabiti veturën qytetarit, u largua në drejtim të Gurrakocit

LAJME

# LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

07/08/2023 22:48



**Policia e Kosovës me një komunikatë për media ka dhënë detaje për vrasjen që ndodhi sot në Klinë.**

Viktima është Anton Prela, ndërsa i dyshuari është Tush Frroku, i cili fill pas aktit është larguar në drejtim të pa njohur, shkruan lajmi.net.

Policia thanë se me të marr informacionin kanë dalë në vendin e ngjarjes ndërsa në Spitalin e Pejës viktima ka arritë pa shenja jete.

Po ashtu i dyshuari sipas policisë duke e kërcënuar me armë, ia ka grabitur veturën një personi dhe është larguar në drejtim të fshatit Gurrakoc.

Në fshatin Kosh të Istogut është gjetur vetura të cilën e ka përdorë i dyshuari.

### Njoftimi i plotë nga policia:

Humb jetën një person nga të shtënat me armë

Më datë 07 gusht 2023, rreth orës 16:50, Policia është informuar se në rrugën “ Leonard Palucaj”- Klinë, ka ndodhur një gjuajtje me armë zjarri.

Policia menjëherë ka dalë në vendngjarje, aty është kuptuar se një person është plagosur nga arma e zjarrit, i njëjti është dërguar ne QKMF-Klinë, dhe më pas në Spitalin Rajonal në Pejë, aty nga mjeku kujdestar është konstatuar vdekja e viktimës.

I dyshuari është arratisur në drejtim të panjohur dhe gjatë arratisjes i dyshuari nën kërcënimin e armës nga një qytetar ka grabitur veturen dhe është larguar në drejtim të Gurrakocit.

Njësitet relevante janë vënë në ndjekje të pësonit të dyshuar dhe me të arritur në fshatin Kosh-Istog, është gjetur vetura e braktisur ndërsa personi i dyshuar është ende në kërkim policor.

Me vendim të prokurorit të shtetit trupi i pajetë i viktimës dërgohet ne institutin e mjekësisë ligjore në Prishtinë për obduksion./Lajmi.net

### Artikuj të ngjashëm



August 8, 2023

**Pamje të reja: Momenti kur Andi Pajaziti “Italiani” largohet nga Bon...**



August 8, 2023

**“Më erdhi keq të dëgjoj se Armend Mehaj ka dhënë dorëheqje...**



August 8, 2023

**“Dëshmitarë kundër Thaçit, likuidime të njerëzve” – PDK kërkon hetim ‘special’...**



August 8, 2023

**Mehaj vjen me një reagim të gjatë, tregon pse japi dorëheqje**



August 8, 2023

**Mërgimtari që e kërcënoi i kërkon falje Hotit: Gjunjzohem para jush,...**



August 8, 2023

**Kurti konfirmon dorëheqjen e Armend Mehajt: Tregon për arsyet e largimit...**

### LAJME TË FUNDIT



**Pamje të reja: Momenti kur Andi Pajaziti “Italiani”...**



**“Më erdhi keq të dëgjoj se Armend Mehaj...**



**“Dëshmitarë kundër Thaçit, likuidime të njerëzve” – PDK...**



**Mehaj vjen me një reagim të gjatë, tregon pse japi dorëheqje**

lajmi.net

info@lajmi.net

Tel: +383 49 131 131

Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrra nr. 5

### Other Links

Fact-Checking Policy

Ethics Policy

Corrections Policy

Ownership & Funding Information

Editorial Team Information

RRJETET SOCIALE

